

INTERVISTË ME FLORINA DULIN

Prishtinë | Data: 10 maj, 2018

Kohëzgjatja: 100 minuta

Të pranishëm:

1. Florina Duli (e Intervistuar)
2. Aurela Kadriu (Intervistuesja)
3. Donjeta Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Aurela Kadriu: Nëse mundesh fillimisht me e prezantu veten edhe me na kallxu diçka edhe kujtimet e hershme të fëmijërisë, çka mban mend prej fëmijërisë, shkollës fillore e kështu me radhë?

Florina Duli: (qesh)

Aurela Kadriu: Çfarë familje je, je...

Florina Duli: Po. Po më kthen mbrapa shumë. Unë quhem Florina Duli, kom lind në Shkup. Faktikisht kom lind me një fshat afër Shkupit me të cilin fshat nuk kemi kurrfarë lidhje, kështu as familja e nanës, as familja e babës. Po në vitet e '60-ta baba jem ka punu si aktor në teatrin e nacionaliteteve në Shkup. Nëna ka qenë e Dibrës, e Maqedonisë, përderisa babin e ka kam pas të rrethit të Medvegjës. Edhe ai mas... gjatë punës si aktor ka qenë mjaft i suksesshëm se gjithmonë ka luajtur role kryesore (qesh), nëse është ndonjë lloj indikacioni. Atij i ka pengu shumë mosshkollimi i vajzave shqiptare dhe mosshkollimi i shqiptarëve në përgjithësi. Edhe e len punën në teatër, fillon një program për emancipimin e grus, në atë kohë në vitet e '60-ta. Ndërlidhet me njëfarë programi zyrtar të qeverisë Jugosllave, në atë kohë që domethënë janë angazhu për emancipim edhe e kanë shpall si program nacional.

Për me përfitu prej asaj, për me nxitë shkollimin e të rive, sidomos vajzave shqiptare edhe e hap faktikisht, e nis një shkollë me një komunitet ku ka pasë shumicë shqiptare, po s'ka pasë asnjë shkollë edhe fëmijët kanë qenë thjesht jashtë sistemit. Edhe gjatë punës vet ka pasë sukses të madh domethënë me krejt peripetitë, t'u fol me familje, t'u fol me hoxhën, t'u koordinu orare, se shumica e fëmijëve kanë shku në mejtep¹ e jo në shkollë. Ma në fund arrin njëqind përqind sukses në, në këtë përgjigjen e familjeve për m'i dërgu vajzat në shkollë edhe djemtë, po vajzat kanë qenë problem pak ma i madh.

Edhe kemi pasë domethënë, jeta jeme ka fillu aty në atë shkollë, krejt banesa jonë, shpija ka qenë e ngjitur me ndërtesën e shkollës, për mua shkolla ka qenë gjithçka (qesh). Edhe kom lujt në oborr të shkollës edhe argëtimin e kam bo thjesht, kam hy nëpër klasa. Edhe me insistimin tim, meqenëse s'kishim çka me bo tjetër në fshat, edhe motra edhe unë kemi fillu shkollën me pesë vjeç. Domethënë kemi shku si, ma shumë si argëtim fillimisht, meqenëse kemi qenë vajzat e drejtorit edhe të mësuesit

¹ Shkollë fillore në xhami, ku jepej edhe mësimi i fesë për besimtarët myslimanë.

na kanë leju me hy në shkollë, pak me i ndihmu nanës se ka pasë shumë fëmijë (buzëqesh). Po kemi qenë nxanse të disiplinume s'kemi pengu edhe në fund faktikisht e kanë pa që jemi shumë mirë me mësimë edhe kanë vendos me na e pranë klasën e parë (qesh) edhe fillimi i shkollës ka qenë ky.

Këta krejt e përmenda meqenëse lidhet me fëmijërinë time, se gjatë asaj kohe fillojnë babën me e përndjekë me e marrë në pyetje se fillon me fitu njëfarë reputacioni aty. Bohet si kryeplak edhe pse ka qenë në atë kohë 25 vjeç (qesh). Edhe në atë kohë autoritetet kanë pasë frikë që ky po bohet njëfarë lideri shqiptar edhe njerëzit po e ndihmojnë, meqenëse filloi edhe me i zgjedh këto kontestet pronësore, divorce, sene, aty problemet mes familjeve. Dhe tregoi njëfarë mënyrë, njëfarë brumi të liderit edhe prej frikës të madhe fillun këta sërëbët, këta maqedonët, më fal, me e marrë në pyetje çdo ditë.

Derisa ai u lodh aq shumë me ato marrjet në pyetje, bisedat informative ndodhshin fillimisht një herë në javë, pastaj çdo ditë, tani dy-tri herë në ditë edhe vendosëm pa asnjë siguri as punë as kurgjo me u zhvendos në Kosovë. Kjo ka ndodh '69-tën (qesh). Domethënë, situata në Kosovë ka qenë shumë ma e mirë në atë kohë, mas demonstratave të '68-tës. Po kemi ardhë domethënë prej një jete tepër idilike, muj me thanë. Ka qenë shumë e lumtur, na kanë dashtë shumë komuniteti ku kemi jetu edhe kushtet e banimit i kemi pasë perfekt, shumë të mira. Përnjëherë kemi ardhë me një banesë me qira, dy prindë pa punë, t'u luftu me gjetë një punë çfarëdo se tash ishim të papërshtatshëm politikisht.

Edhe domethënë kjo ka qenë thymja e parë, ardhja në Kosovë ka qenë një lloj thymje për neve, se prej një jete tepër të mirë kalum në... fillimisht kemi jetu afër shkollës "Gjergj Fishta" pastaj kemi dalë në Vranjevc deri sa e kemi ndërtu shtëpinë tonë. Ka qenë një periudhë shumë vështirë për neve si fëmijë me, me përballu. Po, normalisht fëmijët adaptohen gjithkunj. Pastaj ma vonë e kemi pa që baba ka marrë një vendim shumë të mirë për me ardhë këtu, se me të vërtetë jemi gjetë mirë, kemi kriju shoqni të mirë, edhe domethënë për neve perspektiva ka qenë shumë ma e mirë në Kosovë se që kish qenë në Maqedoni, ma merr mendja (qesh).

Aurela Kadriu: Qysh... a ndodhi me shku në shkollë në Maqedoni disa vite?

Florina Duli: Po një vjet e gjys i kam mbaru atje a këtu kur kemi ardh '69-tën edhe pse kam qenë gjashtë vjeç kam qenë në klasë të dytë, në gjysëmvetorin e dytë, të klasës së dytë.

Aurela Kadriu: E qysh ka qenë këtu, a kishit mujt me na folë mandej qajo kur erdhët këtu, qysh ka qenë ambienti? Jena t'u fol për '69-tën, ka qenë njëfarë kohe...

Florina Duli: Po. Ka qenë interesant se na fillimisht u vendosëm afër shkollës tash që... atëherë u qujt "Branislav Nushiç" tash quhet "Gjergj Fishta". Ka qenë kuadri shumë i mirë i arsimtarëve, i mësuesve edhe shumë mirë, unë fillimisht e kam pasë tepër fshtirë sepse e kemi pas akëntin, mënyra se si kom folë une në gjuhën shqipe ka qenë gjuhë standarde edhe (qesh)... na i thojsim në atë kohë gjuhë letrare, po me ato zanoret tepër të hapuna, sa herë që e çelsha gojën qeshke krejt klasa (qesh). Edhe kështu që unë vendosa mos me u përgjigj në asnjë pyetje deri sa e mësova dialektin e lagjes (qesh). Edhe faktikisht, fillimisht ka qenë një zhgënjim shumë i madh për prindërit e mi se prej nxanësës me

krejt pesa erdha edhe fillova me marrë nisha, rradhazi. Meqenëse, refuzojsha me u përgjigjë derisa tani fillova me i ndrru notat edhe me u bo prapë nxanësja ma e mirë (qesh) në klasë. Po ka qenë një gjashtë mujor kështu bajagi sfidus për mu në fillim.

Aurela Kadriu: A u reflektojke fakti që babi ka qenë i angazhum për shqiptarët në Maqedoni, a u reflektojke këtu, prej sistemit këtu?

Florina Duli: Shiko, unë atëherë kam qenë shumë e vogël për me kuptu edhe pse atë punën e bisedave informative e kom kap edhe pse kam qenë shumë e vogël atje në Maqedoni e disha saktë pse kemi ardhë. Po këtu nuk është reflektu përveç te punësimi, se baba atëherë u dashtë m'u pajtu me një pozitë si përkthyes në gjyq, meqenëse e ka folë sërbsishtën tepër mirë. Edhe thjesht prej një personit që ka qenë drejtor i shkollës, e jo aktor e asi, është dashtë m'u pajtu me një punë si, me u bo një nënpunës bajagi kështu me ndejt me një profil të ultë {përkul kokën dhe shpatullat}, mos m'u ekspozu shumë edhe qajo ka qenë mënyra se si është manifestu.

Përndryshe, nuk kemi pasë telashe në Kosovë në atë kohë prej... por, baba ka qenë pastaj shumë i kujdesshëm, domethënë me kend ka folë, çka ka folë. Shumë gjana për të i kemi kuptu na masi që ka vdek, domethënë prej jerëzve që kanë ardhë me na shpreh ngushëllime e kena kuptu që ai ka qenë edhe domethënë asnjëherë s'ka qenë anëtar i Partisë Komuniste, ka qenë për pluralizëm, ka qenë anëtar i këtyre partive që kanë qenë ilegale, lëvizjet e ndryshme. Ma vonë edhe i pajtimit të gjaqeve, lëvizjes e... domethënë, ka qenë aktivist shumë i madh, po nuk e ka diskutu shumë. Kështu ka qenë shumë diskret.

Aurela Kadriu: A ka punu nana në Maqedoni?

Florina Duli: Nana ka punu në Maqedoni, ka pasë shumë punë ma të mirë. Domethënë, ka qenë, ka punu si mjeshtre e qylymave te Persisë, po kryesisht ka punu në aftësimin e punëtorive. Domethënë, ka themelua punëtori për punimin e qylymave të Persisë edhe e ka bo trajnimin e punëtorëve aty. Aftësimin e tyre profesional, për me ja fillu punës. Domethënë, prej se si vizaton modelet, si shtrohet ai tymi komplet, domethënë atë veprimtarinë ajo e ka pasë për detyrë aftësimin e disa pikave të ndryshme {prek në disa vende sipërfaqen e tavolinës} që janë hapë nëpër Maqedoni. Këtu kur ka ardhë nuk ka mujt me gjetë punë që ju ka përshtatë, kështu që ka fillu me punu në tjerretore, punëtore e fabrikës domethënë ka qenë këtu. Edhe aty është manifestu në njëfarë mënyre ajo papërshtatshmëria politike (qesh).

Aurela Kadriu: A ishte kjo, kjo veprimtaria e punimit të tepihave, qylymave të Persisë, a ishte publike, e shtetit?

Florina Duli: E shtetit {pohon me kokë}, e shtetit ka qenë. Domethënë, ekziston një qilimar, i kanë quajtur qilimar në Dibër edhe atje janë punu këta qilimat e Persisë, që janë thjesht qylyma shumë të shtrenjtë, janë punu kryesisht për treg ndërkombëtar, jo për treg vendor. Shumë pak kanë arritë tregun e ish-Jugosllavisë, sepse kane qenë shumë të kushtushëm edhe shumë gjatë është punu një qylym, domethënë dy-tre muj është bo një qylym. Edhe meqenëse kanë pasë shumë kërkesë prej jashtë,

atëherë kanë fillu me i vend... me i hap edhe punëtori më të vogla nëpër, nëpër Maqedoni. Po në Kosovë nuk ka pasë veprimtari të tillë.

Aurela Kadriu: Më tregut që keni qenë shumë fëmijë në familje. A bon pak për qet' pjesën brenda shpisë...

Florina Duli: Po (buzëqesh).

Aurela Kadriu: Si ka qenë apo si është...?

Florina Duli: Ne kemi qenë... jemi katër fëmijë, tre motra edhe një vëlla. Faktikisht jemi, unë jam e dyta {bashkon duart} e vëllau dhe motra që janë mbas meje, janë bineq. Në atë kohë ka qenë koha e emancipimit ku njerëzit kanë fillu me kriju familje të vogla. Ka qenë ajo koha e familjeve nukleare, ku kanë jetu prindërit pa vjehrrit domethënë, tani ju kemi kthi viteve të '90-ta (qesh) bashkësisë. Dhe kryesisht familja, familja e nanës time, dajtë, tezet kanë pasë ka dy fëmi. Por, prindërit e mi kanë vendos me e bo edhe të tretin, po ju kanë dalë katër (qesh). Kështu që, kemi, jemi shiku kështu pak si domethënë familje me punë ma shumë, meqenëse kemi qenë ma e madhe se tjerët. Po ka qenë kënaqësi shumë e madhe me jetu me një familje ku ke pasë ma shumë vëllezër e motra, se kemi qenë krejt gati të moshës së njejtë. Kështu që, ajo pjesa e fëmijërisë në atë aspekt ka qenë shumë e lumtur se kemi lujt bashkë, ka qenë shumë gjallë edhe shumë të pamvarun prej prindëve (qesh).

Aurela Kadriu: Qysh vazhdoi jeta në Prishtinë mandej, shkolla fillore mandej çka, çka mbas shkollës fillore?

Florina Duli: Po shkolla fillore ishte, po mendoj sidomos për motrën dhe vëllaun tim që e fillun këtu prej klasës së parë ka qenë shumë ma e lehtë, se ata fillun me një shoqni që i pranoi shumë ma lehtë. Na kemi qenë, unë dhe motra ma e madhe në shkollë fillore kemi qenë gjithmonë si ata të ardhura ma vonë. Domethënë, na ka mbet ajo stigma (qesh)...

Aurela Kadriu: Po.

Florina Duli: Që nuk ka vazhdu në gjimnaz. Në gjimnaz ka qenë shumë mirë, po unë... domethënë kemi pasë shumë, jemi pranu tepër mirë prej shoqnisë si në lagje, si në shkollë, si... kemi pasë shoqni shumë të gjanë. Edhe prindët e mi kanë qenë tepër të gjanë sepse na kemi mujt me çu shokë e shoqe në shpi shumë shpesh (qesh) edhe ata na i kanë pritë shumë mirë shoqninë. Kështu që, ka qenë njëfarë vendi ku, ku i ke mbledh të rinjtë, kena diskutu, kemi folë, kemi bo edhe ndeja. E kështu që ajo pjesë ka qenë shumë, shumë e mirë deri '81-tën kur ndodhën protestat faktikisht.

Aurela Kadriu: Cilin vit keni shku në gjimnaz?

Florina Duli: Unë në gjimnaz kam shku '79-tën, domethënë kam qenë gjenerata e parë e mësimi të orientum. Ka qenë pak problematike meqenëse na mas viti dytë është dashtë me ndrru shkollën. Çka i bjen kjo mësimi orientum? Ka qenë njëfarë reforme e viteve '79-'80 ku një, një ekspert, të themi, i

mësimi ka vendosë që me ja përshtatë domethënë, prof... shkollat e mesme me ja përshtatë, edukimin me ja përshtatë nevojave tregut edhe mos me prodhu shumë kuadro me shkollim të lartë, meqenëse s'kishte vende pune të mjaftushme në atë kohë, sipas programeve qeveritare të ish-Jugosllavisë. Edhe u bo një mësim i orientum i cili nënkuptonte që njerëzit mas shkollës së mesme me dalë me një kualifikim profesional, i cili nuk nënkupton që ti, që ishin shkolla profesionale vetëm.

Se ti mujshe me vazhdu shkollimin dhe ma tutje, por nëse për shembull je i orientum në kulturë, nuk ke mujt me shku në shkencë mas shkollës mesme. Nëse je orientu në shkencë ke mujt me shku në kulturë sepse o parapa që ti i ke edhe ato landët që përfshihen. Por, për shembull, unë {vendos dorën në gjoks} kom shku me një drejtim që u qujt (qesh) shumë çuditshëm sepse ka qenë shumë i ngushtë si profesion, si profesion për të ardhmen, ka qenë organizimi i aktiviteteve kulturore (qesh). Edhe domethënë mas kësaj unë kam mujt me shku vetëm në shkenca sociale nuk, nuk ka pasë mundësi me shku me studiu mjeksi a stomatologji a diçka të ngjashme.

Domethënë, ka qenë shumë herët për dikë të moshës tonë me u orientu në atë kohë, me ditë saktë çka po don me u bo prej... por, ka pasë edhe drejtim gazetari, për shembull në gjeneratën time kanë qenë edhe shumë prej gazetarëve tani që kanë qenë edhe ma të njoftun si Blerim Shala, Halil Matoshi, ka qenë Lekë Zherka që ma vonë ka qenë drejtor i KTV-së. Domethënë, qekjo gjeneratë ka qenë.

Aurela Kadriu: Keni qenë në “Sami Frashër” a?

Florina Duli: Prej “Sami Frashër”-it ne kemi dalë te {tregon me dorë mbrapa} shkolla që është tash në kuadër të “AUK”-ut.

Aurela Kadriu: Aha, që është ajo...

Florina Duli: “Eqrem Çabej”...

Aurela Kadriu: “Eqrem Çabej”.

Florina Duli: Po, nuk e di. A beson që s'më kujtohet qysh u qujt në atë kohë...

Aurela Kadriu: Filologjiku është.

Florina Duli: Po, po, si u qujt në atë kohë, se ka qenë një shkollë teknike edhe gjimnazi dy ndërtesa {me gisht tregon distancën}, dy shkolla të mesme me një *compound* [anglisht - kompleks/përbërje], me një, një hapësirë.

Aurela Kadriu: A mos po don me u përgjigj qaty?

Florina Duli: Jo, s'o problem.

Aurela Kadriu: A ju, a ju afektoi '81-shi?

Florina Duli: Po {pohon me kokë}.

Aurela Kadriu: Viti i tretë i shkollës po i bjen, a po?

Florina Duli: Po, '81-shi ka qenë viti i tretë i shkollës edhe na në atë kohë kemi qenë, domethënë rini mjaft rebele, veç u ndje ajo, diskriminimi u ndje mjaft gjatë qasaj periudhe sa kemi shku në shkollë. Po protestat edhe pse kanë ndodhë për neve shumë papritmas, kanë shkaktuar ndasi të madhe mes nxanësve të shkollës. Se kemi qenë na ata që kemi dalë në protestë edhe që kemi qenë përkrahës të protestës edhe ata që kanë menduar që disa protestues qatë, do katurarë (qesh) po na e prishin idilën e bashkëjetesës në ish-Jugosllavi. Edhe ka pasë, domethënë, tani qajo ndasia ka filluar e cila ma vonë u shkri, ka ardhë tu u shkri, po kryesisht shoku ka qenë, u përjetu në mënyrë shumë (qesh) të çuditshme prej, prej ose natyrshëm ndoshta prej, prej njerëzve të ndryshëm në atë kohë.

Aurela Kadriu: A ka pasë bashkëjetesë në Jugosllavi, po mendoj në Kosovë? Ju ndoshta e keni... ju ka ra me përjetu qat' ndarje, a keni pasë shoqni serbë para '81-shit?

Florina Duli: Drejtë me të thonë, familja ime ka jetu me një lagje ku ka pasë shumë, shumë pak serbë. Domethënë, sa ma qendër, sa ma i mirë lokacioni aq ma shumë serbë ka pasë (qesh). Meqenëse, nuk ka qenë sekret që kanë qenë të vendosun nëpër vendet ma të mira të Prishtinës. Ne kemi pasë shumë pak serbë, shumë pak ka pasë shoqim, tepër pak. Domethënë, një lloj ndasije që është shkaktuar ndoshta edhe prej gjuhës. Meqenëse edhe pse ne të gjithë e kemi ditë serbishtën edhe si ke fillu me u rritë e ke fillu me e mësu edhe nuk e ke, as që e ke vërejtë domethënë momentin kur ti ke fillu me folë serbishten. Ka qenë shumë e natyrshme se e ke pasë gjithkrah, televizioni, domethënë administrata shtetnore.

Thjeshtë, çdo fëmijë e ka mësu, ndoshta jo paralelisht [me gjuhën shqipe] por shumë shpejtë. Po nuk ka qenë njëjtë me serbë, serbët nuk kanë folë serbisht, shqip edhe kanë refuzuar me mësu se e kanë pasë landë në shkollë. Ka qenë e papranueshme për ta me ju përkushtu landës shumë se ka qenë, ata e kanë përdorë shprehjen *ispod časti* [serbisht - nën nder] s'ka qenë shumë e... domethënë fisnike si gjest me mësu një gjuhë të një populli që për ta ka qenë gjithmonë i rendit të dytë. Edhe kështu që nuk ka pasë shoqërim, domethënë gjithmonë është, gjithmonë ka ekzistuar ajo jo kompatibiliteti ndoshta (qesh). Qajo, nuk ka pasë domethënë ndonji dashuri të madhe (qesh) mes serbëve dhe shqiptarëve. Ndryshe ka qenë situata nëpër lagje ku ka pasë ma shumë bashkëveprim, domethënë nëpër ndërtesa, banesa ku ka pasë kojshi të parë, ku janë shoqnu edhe ku në njëfarë mënyre janë tejkalu edhe ato barrierat dhe... po kryesisht, në përgjithësi nuk ka pasë, ndonji bashkëjetesë.

Aurela Kadriu: A mësojshit kryesisht serbisht apo... në shkollë, çfarë gjuhe?

Florina Duli: Në shkollë, na kemi shku në shkollë në gjuhën shqipe, literatura ka qenë shqip po sa ma... domethënë kur shkojshë në gjimnaz fillonte veç me pasë problem literaturën, u dashtë me

përdorë literaturë sërbiisht. Shumica prej... bile nëse ke lexu beletrestik², domethënë nëse ke lexu libra, romane ato kryesisht kanë qenë në gjuhën sërbe. Ka pasë në gjuhën shqipe, por ka qenë shumë i limitum, domethënë fondi i përkthimeve. Kështu që, shumë pak ka pasë, na kemi lexu, gjenerata jem ka lexu sërbiisht pa problem. Kemi lexu libra kroatisht, sërbiisht. Përkthimet, ato që kanë qenë ma kualitative si përkthime s'i kemi shiku {shikon poshtë} a janë shqip, a janë... edhe pse unë kam pasë dëshirë me lexu anglisht ma shumë, po s'kemi pasë qasje në libra anglisht shumë (qesh).

Aurela Kadriu: A ju kujtohen protestat e '81-shit?

Florina Duli: Po.

Aurela Kadriu: A keni dalë në mënyrë të organizume kështu, a?

Florina Duli: Jo, jo. Për mu s'ka qenë në mënyrë të organizume. Unë drejt me thanë e di që kur kanë fillu protestat i kam ndëgju prej shpisë edhe zhurmat edhe, edhe që ma vonë m'u ka bo gjithmonë kështu, e kom ditë kur ka protestë prej mënyrës së si vishin zanat deri në lagjen tonë (qesh), prej asaj ekos të njerëzve, mënyra qysh kanë vrapu. Por, atë ditë e di që më ka mbetë motra në protestë edhe une jom nisë me... domethënë, para prindërve të mi ka qenë ajo ni shkas që me kërk motrën edhe qashtu ju kom bashkangjitë ditën e parë protestës, ditën e dytë. Edhe kom dalë me 11, me 26, me 1 dhe 2 prill.

Kemi dalë çdo herë në protestë, ka qenë pak ma interesant dita e 1 prillit, meqenëse kemi dalë tu u kthy mbramje në shpi, e kemi pa që na ka zonë policia me një vend, bash në oborr të shkollës "Vladimir Nazor" ka qenë, në atë kohë u qunte. Edhe t'u dashtë me dalë na prej rrethojës që ka qenë e thyme {shpjegon me duar} na kish prit një polic aty, e burgosi njezin prej grupit, po na tjerët arritëm me ikë edhe mbetëm rrugëve. Vendosëm me flejt në konvikt se atëherë konviktin veç e patën zbrazë edhe e dishim që s'o kërkush, po edhe që s'vjen policia ma në konvikt se veç i patën, me 26 i patën rreh studentat, i kanë largu me dhunë. Kështu që, e dishim që është në njëfarë mënyre vend ku nuk kthehen edhe kemi shku kemi flejt në konvikt. S'dishim se si me ju, me ju...

Aurela Kadriu: Ku është kjo shkolla "Vladimir Nazor", cila është?

Florina Duli: Është "Naim Frashëri".

Aurela Kadriu: Aha, okej, okej.

Florina Duli: Tani kemi ikë nëpër rrugica {tregon me dorë}, kemi shku te konviktet kemi flejt atë natë. Të nesërmen u dashtë me shku në shkollë (qesh). Edhe prej konviktit drejt në shkollë. Në shkollë veç kishin fillu protestat në shkollë e unë s'mujsha me ju bashkangjitë se isha vonu pak, se me hecë prej

² Beletrestika përfshin forma të ndryshme të letërsisë zbavitëse ose estetike, si romane, tregime të shkurtra ose proza.

konvikteve deri {tregon me dorë kahjen} te Normalja, ka qenë mjaft larg edhe kështu që mbeta jashtë rrethojës.

Aurela Kadriu: E në shkollë për çka u protestojke?

Florina Duli: Po me të njejtat kërkesa si edhe në qytet. Pastaj na si grup jemi, kemi shku edhe jemi bashkangjitë protestave këtu të 2 prillit. Unë në atë kohë kam qenë te kjo pjesa që është ëmbëltore “Fellini” tash, te ajo pjesa {shpjegon me duar} domethënë përballë fakullteteteve që janë juridiku, ekonomiku. Edhe ka qenë ditë shumë e keqe se qaty e pamë domethënë ku shkon shtypja, se prun forca speciale edhe kanë pru shumë autoblanda. Për mu hera e parë në jetë i kom pa autobлиндat si duken atë ditë.

Edhe ka qenë një moment kur një ushtarak domethënë apo polic tash nuk e di çfarë, çfarë (qesh) cilësie ka qenë, është, ka dal prej autobлиндës edhe ka vendos me e zbraz revolen domethënë komplet municionin të një revoles tij në turmën që kemi qenë. Na krejt kemi qenë prej 16 deri 19 vjeç, domethënë shumë të ri. Edhe aty është plagos një vajzë mbrapa meje ka qenë {tregon mbrapa saj} une kam qenë në rradhë të parë të protestusve, ajo është... Motra tanë kohën më tërheje {bën sikur tërheq me dorë diçka} për njëfarë jeleku se bike në sy {përshkruan veshjen} ka qenë krejt me vija-vija (qesh) e kisha thurë vet.

Edhe motra më tërhiqte ma mbrapa, më thonte “Hyn ma mbrapa, ma thellë, se po të vrainë” se ish shumë... edhe bijshë në sy, domethënë të fotografojshin. Po unë s’e kisha problem se kur je i ri ndryshe të funksionon truni edhe nuk kisha frikë aspak. Por, më ka tronditë domethënë lehtësia me të cilën na, na domethënë vriste ai ushtaraku që kishin ardhë prej krejt republikave ish-Jugosllave. Domethënë, nuk ka pasë vetëm sërbe, ka pasë edhe kroatë, ka pasë boshnjakë, ka pasë sllovenë në mesin e atyre forcave speciale edhe kanë qenë shumë, shumë të pamëshirshëm në mënyrën se si i kanë qetësu demonstratat.

Edhe atë ditë kemi shku në shpi domethënë, kemi, kur është kry krejt protesta kemi shku. Përmes rrugëve të... nëpër Matiqan kemi shku në shpi në Taslixhe. Ka qenë shumë rrugë e gjatë, po njerëzit na udhëheqshin. Çka ka qenë atë ditë shumë interesant për mu, ka qenë solidariteti që e kanë tregu qytetarët që kanë dalë me na ofru... rrugës dilshin njerëzit me një bukë ose me diçka, që me marrë me hangër pak deri sa të mrrish në shpi. Edhe ka qenë hera e parë në jetën teme {vendos dorën në gjoks} që kam pa diçka të tillë se... (qan) kërkoj falje {fshin lotët, pin ujë}. Deri atëherë kemi mendu që krejt janë... (qesh) kërkush nuk po e aprovon ato çka jemi tu e bo edhe ajo ka qenë njëfarë {ngrit kokën} ngritje e moralit edhe pse na dështum totalisht.

Mas ‘81-tës u bo, u vendos ora policore, nuk mujshe me shku në shkollë ma shumë se tre veta ba... domethënë, ka qenë ndalume me hec si grup, si treshe, se treshi u shihte si grup i organizum (qesh). Domethënë, ka dy, ka dy hecshim në shkollë për me shku. Nuk kishim asnjë shancë për me bo diçka, me u mbledhë apo me organizu një protestë apo çkado tjetër. Meqenëse, kemi qenë tanë kohën të kontrollum, të ka ndalë policia për një asi {prek jakën} sheje. Për shembull, na kishim dëshirë me i mbajt flamurin e Shipnisë në atë kohë edhe të gjithë, gati krejt shkolla jonë e ka pasë ka një {prek

jakën} (qesh). Po për ata hajshe burg, edhe dajak, edhe krejt bashkë. Në shkollë ka qenë, interesant kemi pasë arsi... profesora që na kanë marrë në pyetje, na kanë kërcënu tanë kohën. Na kanë kërcënu me arrestim të prindve tonë, domethënë ka qenë shumë, shumë...

Aurela Kadriu: Shqiptarë a?

Florina Duli: Shqiptarë. Ka qenë shumë sfiduese s'kanë qenë të gjithë të tillë, normalisht shumica kanë qenë me ne, por ka pasë edhe përjashtime. Për shembull, kujdestari jonë i klasës është arrestu '81-tën edhe e kanë dënu me shtatë vjet, sa më kujtohet mu, burg. Prej një profesorit që na merrte tanë kohën në pyetje në zyrën e tij, ai ka qenë atëherë zvendës i shkollës, profesor i gjuhës shqipe, na ka malltretu shumë. Kemi pasë personin e SUP³-it, i cili ka ndejt te burorektorja e shkollës (qesh) tanë kohën, që na ka dëgju çka po flasim. Domethënë, na kemi qenë tanë kohën nën vëzhgim edhe pse kemi qenë shumë të ri edhe s'kemi bo kurgjë diçka në mënyrë të organizume. Krejt ka qenë shumë stihike, shumë e udhëhequn prej zemrës, jo prej ndonji planit madhor.

Por, të gjitha masat preventive për me na lonë me u organizu kanë qenë të vendosuna edhe ajo mbjellja e frikës, dikur kishim frikë me folë me njeni-tjetrin, po meqenëse na morrën shumë shokë në biseda informative. E patën marr një shok {vendos dorën në gjoks} të klasës sonë, e patën mbajrt tre ditë e patën rrah aq shumë sa që kur dul ai tha, "Ju kisha lut mos me m'tregu asnjë gjë, se me m'marr prapë tregoj gjithçka që di". Edhe pse na s'kishim çka me nxirrë diçka naj sekret të madh, po thjesht as thasetheme, mendimet tona private nuk kishim guxim me i shpreh. Ai së paku u tregu shumë fer se na, na tregoi që torturat që ja kanë bo kanë qenë shumë të randa edhe që nuk mundet me i përballu ma. Dhe kështu që na e kemi ditë në klasë me kend mundemi me bisedu lirshëm me kend jo. Edhe po, thjeshtë ka qenë domethënë shkolla, të gjitha shkollat e mesme të Kosovës në atë kohë kanë qenë të mbikqyruna, kështu për së afërmi.

Aurela Kadriu: A keni qenë të torturum fizikisht prej këtij profesorit, prej profesorave që ju merrshin në pyetje?

Florina Duli: Jo, unë jo, a këta... domethënë na e kemi pasë profesorin e ajo nuk ka qenë sekret aspak se ai ka ardhë me *talkie-walkie*⁴ {afion dorën te goja} në shkollë, domethënë me... edhe ka raportu, ka marrë, çdo ditë ka marrë profesora në pyetje, ka marrë nxansa në pyetje. Ka bashkëpunu domethënë me polici. Neve na u zvendësu edhe profesori po për shembull për mu ka qenë shumë, m'ka ushtru dhunë psikologjike se unë isha 16 vjeçe, në vit... '81-shën, edhe ai profesori që na mirrte në pyetje e njipte babën tem. Kanë qenë parashutista bashkë, në të njejtën kohë edhe e disha që e njuh kështu personalisht. Edhe tanë kohën më thonte që, "Ti, na po të shohim çka je t'u bo, krejt çka bon ti, që po shkrun parolla, sendet që i bon për këto veprimet ka me shku në burg..."

Aurela Kadriu: Baba.

³ Sekretariati i Punëve të Brendshme (SPB), pjesë e së cilës ka qenë njësia policore në ish-Jugosllavi

⁴ Paisje audio transmetuese që mund të mbahet në dorë. U shpik gjatë Luftës së Dytë Botërore

Florina Duli: “Baba, meqenëse ti je minorene edhe nuk të kap gjyqi” edhe une në atë moshë je edhe domethënë pak ma naive edhe kisha, më kapke ankthi për babën, mos po ma arrestojnë babën sherri i jem (qesh). Kështu që, shumë ka qenë torturë për mu, ka qenë torturë psikologjike, natën nuk flejsha prej frikës se... Kështu me u ndal nuk mujsha me u ndal (qesh) në anën tjetër kisha shumë frikë për, për babën se qashtu ma pat mbjell atë frikë.

Aurela Kadriu: A të mbështetshin prindërit?

Florina Duli: Na kanë mbështet {pohon me kokë}, na kanë mbështet. Unë e di që kanë pasë frikë, se për shembull atë natë që s’jemi kthy na, nana ka qenë dikund dyzetë vjeçe, kur s’jemi kthy në shpi, 41 vjeç edhe ka fillu duhanin me e pi në atë moshë, s’e ka pi asnjherë. Kur s’jemi kthy prej konviktit, s’kemi shku me flejt në shpi.

Aurela Kadriu: Po

Florina Duli: Se kemi qenë të katërtit fëmijë, edhe motra me vëllaun, 15 vjeç. Kështu që, aq shumë u frigu sa që për me e ngushllu ja kanë ofru cigaren edhe i ka mbet si ves (qesh) deri s’ka mujt me lanë ma asnjherë. Po du me thanë janë frigu shumë, po në anën tjetër na kanë bo me dije që ma përpara e përballojnë atë frigë se sa turpin që na s’jemi mes, s’jemi aty ku duhet me qenë. Ajo ka qenë porosia e babës për shembull. Ai ka thanë, “Ma e randë do të ishte për mu mos të kishit qenë me shokët e juj aty ku u dashtë me qenë se sa që jemi brengos për sigurinë e juj”.

Aurela Kadriu: Çka kanë qenë kërkesat e këtyre protestave?

Florina Duli: Kërkesat kanë qenë... për mu asnjëherë s’ka pasë... kërkesat që kanë qenë deklarative që janë deklaruar aty ansjherë s’kanë qenë të rëndësishme për mu. Domethënë, na kemi kërku kushte, kemi kërku republikë, statusin e republikës. Po për mu ka qenë manifestimi i domethënë asaj që na, shprehja e njohurisë tonë që na çka jemi t’u kalu osht’ diskriminim, ajo çka janë tu e bo është diskriminuese edhe na thjeshtë nuk do të qëndrojmë, domethënë indiferent ndaj diskriminimit që po na ushtrohet. Edhe kur ka fillu ajo e kemi pa që niveli i urrejtjes për neve si shqiptarë në ish-Jugosllavi ka qenë shumë ma i madh se që e kemi ditë para ‘81-tës.

Domethënë, ka qenë njëfarë zgjimi prej njëfarë gjumit, se shumë njerëz kanë mendu që ato që janë thanë deklarativisht prej klasës politike të asaj kohe janë në realizim e sipër që jemi krejt të barabartë, jemi vllazën e motra. Po *de facto* është pa edhe me nivelin e investimit që e kanë bo në Kosovë, në infrastrukturë, në shkollim. Mu më kujtohet prej secilës fazë në jetën teme që kam qenë e diskriminime për faktin që jam shqiptare. Për shembull, kur kom shku une, shkojsha gjyshën e kom pasë ka jetu në Shkup, unë siç thashë kam qenë shumë e pamvarur dhe shumë herët kam udhëtu vet Prishtinë-Shkup me shku te gjyshja çdo pushim vere.

Edhe kur shkojsha në Shkup me ble biletën për me u kthy në Prishtinë, refuzojshin me mu përgjigjë shqip edhe pse krejt e kuptojshin, unë folsha sërbiisht por si e porositsha biletën sërbiisht ata e kuptojshin që unë akcentin e kom, jam me siguri shqiptare edhe fillojshin me m’fy me m’ofendu.

Domethënë, ke pasë ofendime në krejt drejtimet. Por një rast ka qenë shumë interesant se isha në korin e Radio Prishtinës edhe erdh koha e “Akordeve”, na si kor këndojsim si grup në “Akordet e Prishtinës”,⁵ domethënë shumë kangë kanë qenë të shoqnume prej korit të fëmijëve edhe i prunë uniformat në... domethënë, në atë kohë shteti i kish porositë uniformat për korin e Radio Prishtinës edhe na i shpërndanë. Edhe prioritet normal ju dha sërbeve, njëherë i morrën krejt fëmijët sërbë tani ajo pjesa shqiptare se s’kishin porositë sa duhet, si gjithçka që u bo këtu gjithmonë gjysmake (qesh).

Edhe unë i reagoja pa mendu që është politikisht shumë e guximshme, unë ndoshta kam qenë një dhjetë vjeçe në atë kohë edhe shkova te dirigjentja, ajo ka qenë hungareze e martume për shqiptar edhe i thashë, une i thashë, “Kjo është diskriminuese, se ju i dhatë njëherë uniformat krejt fëmijëve sërbë edhe pastaj i shpërndatë çka mbetën të shiptartë”. Edhe ajo mu më ka marrë {sikur tërheq diçka me dorë} përjashtë shpejtë, jashtë ndërtesës së Radio Prishtinës edhe më ka thonë, “A je e vetëdijshme që kjo çka je t’u folë mundet me t’i impliku prindët shumë keq, se kjo është shumë sensitive politikisht çka je t’u thanë ti”.

Edhe unë nuk e kuptojsha pse s’guxoj une me thanë një t’vërtetë edhe thashë, “Unë pavarësisht,” thashë, “kjo është e vërtetë se une pash çka ndodhi”. Po ajo ka qenë thjesht e shokume me atë deklaratën teme. Kështu që, ma pat pru punën domethënë që me m’thanë, “Mos hajde mo në kor se mundesh me i fut prindët në telashe”. Edhe ajo me të vërtetë me shumë qëllim të mirë e boni se jo kështu me më ndëshku, se ajo ishte pak ma e pjekun politikisht se une në atë kohë (qesh).

Aurela Kadriu: Në cilin vit keni qenë në kor?

Florina Duli: Nuk më kujtohet saktësisht, po ka qenë në vitet ‘70-ta, definitivisht vitet e hershme të ‘70-ta.

Aurela Kadriu: Çka bojshit në kor, a knojshit për radion a, çfarë kongë knojshit...?

Florina Duli: Po, po. Domethënë, komplet kori ka qenë në shërbim të “Akordeve të Kosovës” të festivalit në atë kohë edhe knojshim për, ushtrojshim kangë që kishin me u këndu në “Akorde” dhe kangë të përzime. Ka pasë kangë shqip, sërbisht, turqisht, varësisht se çfarë ka qenë përzgjidhja për “Akorde”, normal kanë qenë krejt gjuhët (qesh).

Aurela Kadriu: A ju kanë qit krejt bashkë?

Florina Duli: Krejt bashkë po, po. Ka qenë një grup, një kor i përzim i fëmijëve shqiptarë edhe sërbë. Ka pasë mjaft, une mendoj që kanë qenë dikund ma shumë se prej 30 deri 50 fëmijë që kanë këndu në atë kor të... ka qenë vullnetare, domethënë je lajmëru vet prej kush ka dashtë. Unë kam qenë shumë kështu e gjallë, gjithmonë kom kry aktivitete jashtë shkollës.

Aurela Kadriu: “Akordet e Kosovës” ku u majke?

⁵ Folësja e ka fjalën për “Akordet e Kosovës”.

Florina Duli: Janë mbajjt atë vit sa e di une, jan mbajjt në objektin e Radio Prishtinës.

Aurela Kadriu: Çka ka qenë ky festivali?

Florina Duli: Festival i fëmijëve, ka qenë shumë kështu çdo vjet janë mbajjt “Akordet”, kanë qenë “Akordet e Kosovës” kanë qenë për të rritur edhe për fëmijë. Ka qenë festival shumë, shumë kështu i njoftun në (qesh), në Kosovë gjatë atyre viteve. Çdo kongë krejt që i dijmë tash si, “Kur pranvera erdhi në Prishtinë” e këto janë këndu si pjesë e... janë komponu apostafat për atë festival edhe janë, domethënë të gjeneratës time krejt e njohin si, si festival tradicional i Kosovës, që është shu mas ‘89-tës.

Pjesa e Dytë

Aurela Kadriu: A mbërrijtët me përfundu shkollën e mesme, a ju bonën probleme?

Florina Duli: Jo, e përfundova shkollën e mesme edhe mas shkollës së mesme, domethënë e regjistrova Fakultetin Juridik. Ka qenë prapë qajo periudhë, ka pasë ende orë policore, shumë kohë e pakohë, por unë jom martu tani gjatë vitit të parë të studimeve edhe më binden komplet shoqnia edhe miqt edhe krejt që “Ti nuk mundesh me vazhdu Fakultetin Juridik si nanë”, se isha shatëzanë me vajzën e parë, “Kështu që, zgjidhe një fakultet ma të lehtë”. Unë e regjistrova anglishten. Domethënë, e lash vitin e parë që e kisha kry të juridikut dhe kalova në fakultet, në Gjuhë dhe Letërsi Angleze.

Aurela Kadriu: A ka qenë, qysh ka qenë fakulteti i Gjuhës Angleze atëherë, a ka pasë kuadër?

Florina Duli: Ka pasë kuadër shumë të mirë. Ka pasë edhe lektorë [ligjerues] të huj, por unë isha kështu me *part time* [gjysëm orari], domethënë isha studente me korrespondencë i thojshim në atë kohë edhe me qenë se kisha fëmijë edhe nuk mujsha me i ndjek krejt ligjeratat. Kështu që, kom ma shumë prej shtëpie, shumë rallë m’ka ra me shku në fakultet, veç se në provime (qesh), që ka qenë në njëfarë mënyre pak diskriminuese se nuk më njihshin profesorat edhe apriori ishin ma skeptikë ndaj aftësive të mia. Kështu që, një notë e merrsha ma të ult për faktin që nuk shkoj në ligjerata si krejt të tjerët, se fakulteti i anglishtes ka qenë, grupet kanë qenë shumë ma të vogla se për shembull në Juridik edhe aty krejt jonë njoft, profesori e ka njoft secilin student.

Unë kur shkojsha kështu si person i panjoftun për të gjithë ka qenë shumë interesant (qesh) se kërkush nuk më kish pa deri në ditën e provimit, por mirë. E kom kry domethënë krejt me afat, kom msu bajagi shumë se nana u kujdeske për fëmijtë e mi, se tani unë gjatë fakultetit i bona tre fëmijë (qesh)... edhe ajo kujdesej. Edhe unë për me ja shpagu mundin e kujdesit të saj, se ish bajagi sfidë, msojsha shumë që me qenë e sigurtë që kom me dhonë provimin, që mos me pasë nevojë ajo për të njejtin provim s’paku dy herë me më ndihmu. (buzëqesh)

Aurela Kadriu: A keni fillu me punu në këtë kohë, m' duket më keni tregu.

Florina Duli: Unë në '89-tën kom fillu me punu në Shkollë të Mesme të Muzikës, tani kom punu edhe në shkollë të mesme teknike me dhonë gjuhë angleze, por menjëherë në të '90-tën tani është mbyll shkolla edhe kalum në {bën shenjën e thonjzave} ilegalitet, (buzëqesh) sistemin paralel.

Aurela Kadriu: E di që e keni një tregim shumë specifik për shkollën e muzikës, që ka qenë njëfarë shkollë kështu...

Florina Duli: Po, po pak ma avangardë, se kanë qenë domethënë krejt ata që kanë punu aty kanë qenë njerëz që domethënë jonë marrë profesionalisht me muzikën, e për m'u marrë profesionalisht me muzikën për atë gjeneratë ka nënkuptu që vjen prej një familje që qëndron mirë materialisht. Vitet kur kalum, domethënë kur u mbyllën shkollat kishte një lloj kordinimi mes në atë kohë me LDK-në, me sindikatat si, çfarë qëndrimi me marrë kush, por shkolla jonë e muzikës, mori...

Aurela Kadriu: A erdh kjo kur erdhën kurikulat?

Florina Duli: Ka qenë domethënë, qato dy gjana kanë qenë totalisht të papranushme, kështu zyrtarisht ajo ka qenë linja jonë. Domethënë, na s'e pranojmë kurikulën tonë nëse msimi i historisë edhe gjuhëve ka qenë me çertifikatat me stemën e Vuk Karadžić. Domethënë, kanë qenë totalisht të serbizume me njëfarë mënyre. Prej çertifikateve që kanë qenë totalisht, domethënë neutrale u serbizu edhe një lloj manifestimi i mospajtit, por unë mendoj që edhe prej anës serbe janë bo pikërisht për me arritë atë qëllim, që me i mbyll shkollat.

Më duket që në atë kohë autoritet jugosllave që rreziku prej shqiptarëve ju ka ardhë pikërisht kur shqiptarët kanë fillu m'u shkollu edhe aty e vendosën fokusin te arsimit, mbyllja e arsimit, por në njëfarë mënyre me na lonë neve fajin. Në atë kohë Kosova ka qenë totalisht jashtë vëmendjes ndërkombëtare, domethënë nuk ka pasë kurrëfarë jehone fakti që në Kosovë u mbyllën krejt shkollat në gjuhën shqipe fillimisht. Tani u rihapën shkollat fillore, por të mesmet edhe Universiteti jo. Edhe në atë kohë, domethënë komplet struktura e shkollës, hierarkia qysh ka qenë, domethënë struktura e menaxhmentit u largu është zëvendësu me një strukturë të përkohshme, thojshin ata "ushtrues detyre".

Te na shumë kohë është dashtë me kalu që ushtruesi i detyrës me fitu atë konotacionin neutral, se ka pasë gjithmonë konotacion negativ, se ushtrues detyre i drejtorave të shkollës kanë qenë të instalum prej Serbisë edhe e bonë një kolege tonë në shkollë të muzikës drejtoreshë të shkollës e cila ishte faktikisht edhe ndrikulla e një kolegës tonë shqiptare, e fmijëve të saj edhe ata e kishin shkëmby këtë (buzëqesh) shërbim njona-tjetrës. Personin e parë [që ajo] e largoi ajo prej pune ka qenë faktikisht shoqja e vet ma e ngushtë edhe drikulla e fmive të vet, që me na dhonë neve mësimin që, "S'e kom kursy Lulen, s'e kursej asnjë prej jush..." edhe na pak me naivitet as që i pritëm me na i lshu vendimet e largimit nga puna.

Kështu që, totalisht e lshum punën edhe kolegët e mi ma të vjetër vendosën që me lutë drejtoreshën e re që me bo një përjashtim për shkollën tonë, që meqenëse ishte shkollë e muzikës, ma profesionale,

ku nuk lunte rol shumë ndryshimi i planprogramit edhe kurikulës e... edhe pse një takim kordinus në mes stafit shqiptar të shkollës u murrëm vesh që me shku me i thonë drejtoreshës të re që na ty nuk të pranojmë si drejtor të dhunshëm, por aty gjatë takimit u ndrru fjala. Po thotë një kolegë i joni, “Kqyre na njihemi moti, na duhet me kuptu njoni-tjetrin, shkolla jonë është jo-politike. Na krejt jemi me muzikë, me art edhe ju kishim lutë që me mudësinë me na leju neve me punu”. Edhe ajo filloi me njëfarë taktizimi aty edhe mu m’u duk që është tradhti me njëfarë mënyre që nuk ja tham ato çka ishim marrë vesh, se drejtor e njohim filan filanin që ka qenë drejtor deri atëherë.

Unë e thashë, por tani kolegët e mi kërkun falje në emër tem (buzëqesh). Unë e thashë shumë vrazhdë, thashë që, “Na kemi ardhë me të thonë që nuk të pranojmë ty si drejtoreshë edhe që më befasojnë kolegët e mi që nuk ja u transmetun ato që jemi marrë vesh me thonë, e sa për kërkesën e kolegëve të mi që ju me pa mundësinë me na leju me punu, unë e di që nuk osht’ vendimi i juj se juve s’ju pyt askush. Ju jeni marionetë e Beogradit, nuk kemi çka me diskutu aty. Dihet cili është qëndrimi i shqiptarëve, cili është qëndrimi i serbëve. Nuk besoj që na, palët që ktu jemi ulë jemi në pozitë me bo kompromise të tilla.” Ajo filloi pak me më urrejt, por edhe kolegët e mi kërkun falje. Thanë, “Kjo është ma e reja prej kolegeve, nuk din çka po flet”. Edhe mirë.

Në takimet tjera me drejtoreshën jonë marrë vesh kolegët pa mu, meqenëse unë veç nuk isha e pranushme që me vazhdu msimin prej të hanës. Edhe të hanën kur kanë shku në shkollë i ka pritë policia edhe i ka rrah shumë prej kolegëve të mi. Unë normalisht s’kom shku, se s’kom qenë e njoftume që ka tentativa të tilla që me vazhdu msimin në objekt të shkollës edhe kështu që e kom marrë vesh pak ma vonë. Por, nejtse, sidoqoftë edhe ajo ka qenë në kordinim me sindikatën e arsimit se e kanë marrë një leje paraprake edhe ata ja u kanë dhonë aprovimin tu e ditë shumë sakt që edhe nëse don pala jonë, pala serbe s’ka me pranu asnjëherë.

Pak ajo ku kena dashtë na m’u dallu si shkollë e muzikës nga shkollat tjera (qesh), e tani kemi fillu domethënë me majtë msim nëpër objekte private. Kanë qenë dy objekte. Ka qenë objekti i Agim Avdiut, shpia e tij që na u ka dhonë në përdorim edhe ka qenë objekti i... tash shumë po më vjen keq, s’po më kujtohet emri, por vajza është Mrika Gashi, baba i Mrika Gashit që është drejtoreshë në ARDA [Association of Regional Development Agencies]. Ai na e ka dhonë shpinë e vet. Dyjat kanë qenë në të njëjtën lagje, domethënë shumë afër shkollës së vjetër të muzikës, objektit zyrtar të shkollës. Kemi vazhdu aty kemi mbajtë msim një kohë të gjatë (buzëqesh).

Aurela Kadriu: E qysh ka qenë msimi nëpër shpia për shkollën e muzikës? Ata e kanë ma specifike.

Florina Duli: Po shiqo, te landët ku u dashtë me pasë instrumente, kryesisht janë përdorë edhe shpiat e arsimtarëve ose të nxansave, janë bo msimet individuale, por pjesa teorike u mbajt në ato dy objekte. Kemi pasë problem shumë për landë profesionale, por janë tejkalu, gjithmonë është gjetë një zgjidhje. Ka qenë shumë interesant se domethënë komplet msimi është zhvillu në qaq mënyrë serioze thu ti që me të vërtetë ka me u marrë shumë seriozisht. Por, ndoshta fillimisht nuk e kemi ditë sa ka me zgjatë, kemi qenë shumë naivë se kemi mendu që kjo o një padrejtësi aq e madhe që nuk mundet, s’ka teori që me zgjatë ma shumë se tre, katër muj edhe dikur ka me marrë dikush vesh çka po na ndodh

edhe kanë me reagu s'paku Bashkësia Ndërkombtare. Kërkush nuk e ka pritë që ajo gjendje ka me zgjatë dhjetë vjet, nontë vjet sa zgjati.

Aurela Kadriu: Qysh ishte për juve si mësimdhanëse ecja nëpër qytet, a kishte rrezik?

Florina Duli: Po gjithmonë u dashtë me ndrru rrugën, mos me... nuk kemi pasë na frikë secili për veti, por ma shumë kemi pasë frikë mos po ja çojmë policinë pronarit të shpisë edhe mos të na vjen dikush në kohën kur fmitë janë në msim, mos i malltretu fmitë. Kështu që, qajo ka qenë frika ma e madhe e sidomos për mu, se unë punojsha në atë kohë edhe në Këshill të të Drejtave të Njeriut. Prej vitit '90 kom qenë në Këshill edhe kemi mledhë shumë dëshmi të shkeljes të drejtave, domethënë shkeljen e të drejtave në atë kohë nuk kanë qenë në nivelin e sotit, kanë qenë ma shumë normative apo të zbatimit të ligjit, kanë qenë rrahje, vrasje, ka qenë një rast kur pikërisht nxanësit të shkollës të mesme ja patën pre veshin policia.

Ka qenë shumë, shumë të randa edhe na i kemi mledhë dëshmitë edhe me fotografi për me qenë ma bindës te organizatat ndërkombtare, të cilat kanë qenë faktikisht audienca jonë si Amnesty International, paraardhësi i komisionerit të të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkume, e kemi Human Rights Watch këto organizata. Kështu që, kemi mbledhë dëshmi, kemi mbledhë dëshmi prej mjekut, vërtetim çka i ka ndodh. Krejt ato kanë qenë në njëfarë mënyre jozyrtare, se ato zyrtarisht nuk kanë mujt me na i ofru ato informata, por edhe fotografi.

Na kemi pasë aty në Këshill albumin e horrorit, që kur ja tregojshim tani delegacioneve të huja na për veti u smujshim nja dy ditë nuk vijshim në vete, se me çdo kusht e evitojshim me hap albumin se ka pasë... për mu sidomos në atë kohë edhe pse kom pasë fmi kom qenë relativisht e re. Për me pa çdo ditë fotografi të kufomave, të viktimave të dhunës, të rrahjeve brutale, personave pa vesh, domethënë tu ju shku gjaku ka qenë shumë e randë edhe s'lejke ankthi tani me flejt.

Aurela Kadriu: A keni qenë në Këshill qysh prej formimit?

Florina Duli: Pak ma vonë se që është formu më kanë thirrë me dhonë kontribut për shkak të njohjes së gjuhës angleze. Se në atë kohë ata mujn me pasë një ide krejt tjetër, por ka pasë shumë pak njerëz që e kanë folë anglishten kështu në mënyrë që ka mujt me u përdorë për pak ma shumë se një komunikim dhe një konverzacion i zakonshëm. Kështu që, krejt edhe anglishtja jonë që kemi përkthi dokumente ka qenë, ka lonë shumë për të dëshiru (qesh). Por mjaft, prapë se prapë ka qenë mjaft për me mujt me transmetu një lloj mesazhi jashtë edhe aty kom qenë domethënë prej vitit '91 deri '93.

Aurela Kadriu: Në Këshill?

Florina Duli: Në Këshill. Kom punu mjaft shumë, se punojshim ka dhjetë ore, dymbdhjetë orë shoqëro delegacione, përkthe për gazetarë, tani i majshim nëpër shpia gazetarët që vijshin ose delegacionet se ata vijshin në mënyrë të msheft për me mujt me pasë qasje te shqiptarët. Përndryshe, nëse u lajmrojshin zyrtarisht ardhjen në Kosovë atëherë, Ministria e Informimit e asaj kohe ja bonte edhe itinerarin e takimeve, kështu që edhe ka pasë shumë punë. Domethënë, kemi punu kohë të gjatë ka

dhjetë orë, dymbdhjetë orë po thom në ditë ka qenë dita e punës në Këshill, vullnetarë total, pa cent, pa... na s'e dishim edhe konceptin e OJQ-së (buzëqesh). Na drejtë me thonë nuk e... se ka qenë Këshilli organizata e parë joqeveritare. Unë ndoshta kanë kalu katër pesë vjet prej themelimi të Këshillit për me kuptu çka nënkupton një organizatë joqeveritare. Por kemi punu, domethënë misioni u kry pa e ditë teorinë mbrapa organizimit të shoqërisë civile që ekziston tash. Është shumë i njoftun edhe ka qenë i njoftun në botë.

Aurela Kadriu: A keni qenë të targetum gjatë kohës sa keni punu në Këshill? Krejt ekipi o fjala, najherë?

Florina Duli: Po, patjetër që kemi qenë, domethënë nuk osht'... na kanë përcjell. Për shembull, unë e di që qajo ka mujt me qenë arsyeja pse na e kanë djeg shpinë tani gjatë luftës, se në Prishtinë janë djeg shumë pak shpia, e tonën e kanë djeg deri në temel. Domethënë, nuk e kanë djegë një herë, por e kanë djegë dy herë. Se kur e kanë djegë herën e parë ka shpëtu edhe jonë kthy edhe e kanë djegë prapë edhe një herë me kasetë, policia e ka djegë me listë. Edhe kështu që krejt kojshitë e mi serbë, në ato kohë kom pasë kojshi serbë, kanë dalë edhe kanë festu në rrugë. Kanë qit tavolinë, raki, gota edhe kanë festu që Nezirit dhe Florinës po i djeget shpia si nacionalistat ma të mëdhenj të lagjes (qesh), sipas tyne.

Aurela Kadriu: Deri në cilin vit vazhdu me dhonë msim në shpia?

Florina Duli: Deri në '93-tën kom dhonë msim. Kom dhonë tani msim edhe në DIF edhe në Shkollë të Muzikës, po në '93-tën në Këshill të të drejtave të njeriut erdh Delegacioni i "Mjekëve pa kufi" edhe unë i shoqnova ata nja një javë nëpër terren nëpër Kosovë me pa, ka qenë një *fact finding mission* [eng. mision i gjetjes së fakteve] se çka ka nevojë Kosova për me ndihmu sistemin. Ata kishin ardh me vendos një lloj sistemi paralel të shëndetësisë tu e pasë të qartë që na s'po kemi qasje nëpër spitale ashtu të lirë qysh u dashtë me pasë qytetari dhe në atë kohë unë i shoqnova. Atyne i ka pëlqy mënyra se si unë ju kom ndihmu, prapë ka qenë domethënë në bazë vullnetare pa asnjë cent, por si mision i Këshillit i të Drejtave të Njeriut mi ju asistu delegacioneve të huja edhe kur vendosën me hap zyrën në Kosovë.

Ata kishin shku kishin mbledh fonde, ma bonën ofertën që me punu për ta edhe ajo punë ish qashtu njejt. Unë në asni moment nuk kom mendu që kom me lshu Këshillin e të punoj për "Mjekët pa kufi", por ish papritmas një punë që u pagujke. Domethënë, familja ime dilke prej krizës, por kisha mundësi edhe me ju ndihmu familjeve tjera me rrogën që e merrsha, se dilte për me ju dhonë edhe të afërmve që ishin pa punë edhe mendojsha që kom me pasë kohë me u angazhu edhe në Këshill. Por, faktikisht edhe aty kemi punu nga dhjetë orë në ditë minimum gati, gati edhe vikendeve.

Kështu që, një kohë të gjatë e kom bajt Këshillin, kom shku çdo të diele kemi pasë takimin në ora dhjetë të mëngjesit krejt antarësia prej krejt Kosovës edhe jemi taku. Në të vërtetë, mos ka qenë një herë në muj se tash kom harru, veç e di që të dielave e kemi pasë takimin. E një e diel në muj ka qenë për krejt Kosovën, krejt degët e nëndegët e Këshillit. Një kohë të gjatë kom vazhdu me marrë pjesë edhe në ato takime, por dikur u lodha edhe nuk kisha mo mundësi me përcjellë (buzëqesh).

Aurela Kadriu: Çka bojshit me “Mjekët pa kufi” ? Çka shihshit? Çka ishin përvojat?

Florina Duli: Po me “Mjekët pa kufi” fillimisht vendosëm me bo njëfar *screening* [eng. analizë] të nevojave si sektor për me mujt me pasë, me ndihmu. Shqiparët u dashtë me pasë një lloj programi zyrtar me spitalet publike me na leju policia tani me ndihmu këtë pjesën tjetër edhe kryesisht, faktikisht ky sistemi shëndetësor i “Nanës Terezë” osht’ përkrahë kryesisht me barnat që i ka sjellë “Mjekët pa kufi”. Qajo lista e sociale, krejt barnat që i kanë pasë ata kanë ardhë në shumicën e raste prej “Mjekëve pa kufi”. E ka pasë planin e shpërndarjes, domethënë sakt e kemi ditë sa kanë nevojë, cila lagje, cila... edhe hapja e ambullantave të “Nanës Terezë” faktikisht nuk kish mujt me ndodh mos të kish qenë për “Mjekët pa kufi” edhe zotimi i tyne për me pru barna.

Kanë qenë edhe organizata të tjera si Mercy Corps që e ka ndihmu këtë shërbimin e akusherisë edhe maternitetit për shembull. Kemi ndihmu edhe ne si “Mjekët pa kufi” por ata e kanë nxitë fillimisht, i kanë nxitë këta akusharët e Kosovës për me u lajmru si vullnetarë aty. Po 90 përqind gati të ndihmave të “Nanës Terezë” për barna i kanë ardhë prej “Mjekëve pa kufi”.

Aurela Kadriu: Deri në cilin vit keni punu në “Mjekët pa kufi”?

Florina Duli: Unë në “Mjekët pa kufi” kom punu deri në ‘97-tën, pastaj kom kalu te Save the Children edhe jom marrë ma shumë për promovimin e Konventës të Drejtave të Fëmive, me drejta të fëmive, me përfshirjen e fëmive edhe pse kanë qenë shumë jashtë kohës, u repliku programi i Save the Children që ishte në pjesën tjetër të Jugosllavisë edhe në Kosovë. Unë ju tregojsha që na jemi në rrethana komplet tjera edhe që ajo çka ata pritshin prej Save the Children në Kosovë ishte shumë qesharake. Kështu që, komplet u ri-orientu programi Save the Children për Kosovë. Veç unë kom qenë në fillimisht deri ‘98-tën, ‘97-‘98 kom qenë veç unë përfaqesuese e Save the Children në Kosovë, tani kur fillova me dalë në terren edhe dilshim gjatë luftës me organizata tjera e pashë të arsyeshme që me kërkun prej tyne me na dërgu edhe kolegë ndërkombtarë. Me na ardhë dikush me makinë, që me dalë edhe vet në terren, meqenëse ishte shumë e vështirë si shqiptare me shku në emër të organizatës, me i kalu krejt punktet pa e pasë naj ndërkombtar me veti. Qajo ka qenë arsyeja pse ata na dërgun kështu kolegët e huj edhe atëherë u rrit edhe programi.

Kemi dizajnu programe, ndihma për personat që kanë, për shembull që janë vendosë jashtë shpijave edhe kanë nejt në hapësirë, në vende të hapuna, nëpër male, nëpër ambiente të jashtme. Atë kohë e kemi zhvillu njëfarë programi të ndihmës kur shkojshim në terren e shihshim çka i duhet një familjes që jeton në hapësirë edhe e zhvillum njëfarë *kit*⁶ i thojshim na. Ka qenë ajo burja e pllantikës ku i kemi fut, ku ata mujshin me mbajt miellin mos me ju lag, tani najllona, jo mushama najlloni mos me i lag shiu fëmitë, broshura qysh mos me u nda në rast kur ikin prej policisë, qysh me evitu që mos m’u gjetë mo. Për shembull, ka pasë broshura që ne ju tregojshim që prind duhet bebeve me ju shkru një numër të telefonit jashtë diku, diku jashtë, se gati secila familje e kishte dikend jashtë, që me qenë ajo që kushdo që e gjenë një fmi që u nda prej familjes me ditë ku me lajmru ku osht’.

⁶ Eng.: *kit*, jë listë me artikuj të domososhëm për familje në nevojë.

Domethënë kjo, një kohë kanë qenë kogja të qëllume ato gjanat edhe pse kur i mbanë ti mendon se asnjëherë s'po bon mjaft sa duhet se nevojat ishin shumë të mdhaja, por tani kemi pas luftime që faktikisht intervenimet tona kishin qenë mjaft strategjike. Por, m'ka ra me shku shumë në terren edhe gjatë asaj kohe kom shku në terren, se sa herë që dikush prej gazetarëve të huj apo delegacioneve të huja kërkonte me dalë në terren edhe nuk gjejshin njerëz që e kishin guximin me dalë, më thirrshin mu se e dishin që une jom pa si ma e çmendun (buzëqesh) edhe s'kisha frikë.

Kështu që, prej domethënë ballafaqimi i parë me luftën ka qenë kur e kom çu një gazetare gjermane me pa masakrën e Likoshanit edhe Qerezit. Shumë pak kanë depërtu gazetarë atë ditë. Unë të drejtën me të thonë nuk e kom ditë gjeografinë e Kosovës aq mirë deri atëherë që u dashtë me u gjind, me pa se si mujm me shku pa harta me shku deri në Likoshan edhe Qirez m'i mrri me shumë peripeci edhe pse ajo gazetarja që ka qenë na e dha LDK-ja me urdhër të njëfarë mënyre të Ibrahim Rugovës. Ata ja kishin dhonë edhe truprojen e vet për me dërgu. Ajo ka qenë gazetarja e parë gjermane që ka bo intervistë me Ibrahim Rugovën si kryetar, në cilësinë e kryetarit të Kosovës, si President. Por, ajo ka qenë qaç e njëanshme sa që refuzonte me pa të vërtetën në... e masakrës.

Domethënë, na kemi qenë aty, kemi pasë njerëz që na kanë tregu se si kanë ndodh vrasjet, kemi shku i kemi pa krejt skenat e vrasjeve edhe në fund deri sa e kemi prit kamionët me trupa për me ardh edhe me fillu vorrimi, i cili ka ndodh tepër vonë, se trupat mas obduksionit, kinse obduksionit {bën shenjën e thonjëzave} kanë arritë tepër vonë në Likoshan. Edhe ceremonia e vorrimit, domethënë krejt kom qenë aty prej fillimit deri është përfunduar ceremonia e vorrimit. Bile asnjëherë s'e harroj se njëna, një plakë domethënë, zoja e shpisë së familjes Ahmeti i kontrollonte trupat tu e kërkun nipin e vet. Asaj ja kishin vra nantë ose njëmbëdhjetë, tash më duket që njëmbëdhjetë vetë të familjes, krejt djemtë edhe krejt nipat, domethënë të gjithë meshkujt e familjes që i kanë gjetë. Edhe ata trupat ishin në kamion edhe... nëpër traktorë në të vërtetë të vendosun edhe ajo shkonte tu i pa edhe kërkonte nipin ma të vogël.

Normal që ishte në shok, se kur ta vrainë një njeri mundesh me qenë tu e vajtu e tu u mërzitë, por kur t'i vrainë njëmbëdhjetë vetë ti je, jashtë vetes del njeriu edhe ishte në shok. E kërkonte në mënyrë shumë joracionale nipin ma të voglin me pa, e ndërkohë dikush i familjes të asaj tha, "Po na duhet një laps, një kimik për me ja u shkru emrat që të mos i ngatrojme varret". Unë e kisha një kimik me veti edhe ja dhashë. Me atë kimik jonë shkru ata emra në ato qefinet e atyne. Ajo ka qenë shumë prekse, tepër prekse. Ai kërkimi i asaj ka qenë shumë, shumë për mu ka qenë tronditëse edhe në atë moment gazetarja gjermane më pyet, "Domethënë, është e vërtetë që ju shqiptarët nuk i qani të vdekurit se e pranoni vdekjen si shumë normale, se keni shumë fmi edhe domethënë s'ju bon përshtypje nëse dikush".

Aty unë e kom pa që ajo thjeshtë nuk mundet me qenë gazetare profesionale nëse e kish një qasi bindje për cilindo popull, që domethënë pajtohet shumë lehtë me... domethënë e kish ble atë propagandën serbe, se ajo ishte korespondente e "Der Spiegel" e vendosur në Beograd. Edhe pastaj na kanë dërgu te vendi i ngjarjes, ku faktikisht njëri prej të vramve të familjes Ahmeti ja kishin thy kafkën me gurë edhe kishin metë copa truni edhe familja e kish rrethu, domethënë skenën e krimit edhe

kishin vendos disa shenja për me i pa na. Ajo refuzonte me i pa, thonte “Nuk po shoh unë kurgjo, kjo osht’ krejt rrenë, s’po shoh”. Ato ishin tepër zor mos me i pa, ishin shumë të qartë. Nejse kishte fillu me ra muzgu por... edhe pastaj unë i pata thonë asaj gazetares që mu mos me më kontaktu mo kurrë.

Ata e bojshin një lidhje gazetarët tani gjithmonë vishin te ti për me vazhdu bashkëpunimin kur u kthejshin në Kosovë, e asaj i pata thonë që unë mo asnjëherë. Fatkeqsisht ajo ka qenë gazetare që ka fitu “Pulitzer” për gazetari, kështu që për mu “Pulitzer-i” nuk e ka peshën duke marrë parasysh që Renate Flottau e ka marrë “Pulitzer” (buzëqesh) {zgjatet dhe kap gotën me ujë}. E kur është botu qaj numër i “Der Spiegel-it” ku është botu shkrimi i saj, domethënë ka qenë shumë e qartë ajo çka kom mendu unë, që ajo ka qenë totalisht e njëanshme kur e ka shkru shkrimin. Faktikisht në asnjë tregim se si ka ndodh ngjarjet e vrasjeve nuk ka besu edhe e shpreh shumë qartazi.

Ajo është ajo gazetarja që gjindet në shtëpinë e Ibrahim Rugovës gjatë bombardimeve, nëse ju kujtohet që ka qenë një gazetare, ka ndejt aty, osht’ sjellë thu ti osht’ kusherinë e Ibrahim Rugovës. Unë nuk e di ata, ajo lidhja e LDK-së me atë gazetare, ndoshta kanë dashtë edhe me kap në njëfarë mënyre me bo për vete, por fatkeqsisht unë mendoj që nuk është dashtë me investu as edhe një minut kohë për të, se ka qenë thjesht... nuk ka pasë ndonjë mundësi me kthy me bo gazetare të paanshme, se ka qenë veç e vendosun në kokën e vet që na shqiptarët i kemi fajet për çka po na ndodhë me serbë.

Pjesa e Tretë

Aurela Kadriu: A kishit folë pak për marsin e ‘98-tës, respektivisht për angazhimin e juj në protestat e grave. A mundeni me folë pak për këtë pjesë, qysh vjen deri te organizimi i protestave të marsit?

Florina Duli: Po, ka qenë shumë interesant. Unë mendoj që shumë ka pasë spontanitet te organizimi i protestave me letër të bardhë, organizimi i protestave me bukë. Ato nuk kanë qenë shumë të... shumë kështu naive me qenë se në atë kohë veç se filloi njëfarë *shuttle diplomacy*⁷ me Kosovë. Vijnshin, domethënë e panë bota që ktu po ndodhë diçka, sidomos me ardhjen e “Mjekëve pa kufi” të cilët raportojshin për situatën e të drejtave të njeriut, që ishin tash burime shumë ma të besueshme se që ish Këshilli i të Drejtave të Njeriut e LDK-ja, meqenëse ishin ndërkomhtar. Jo ishte Kryqi i Kuq ndërkomhtar, jo Federata e Kryqit të kuq ndërkomhtar, Organizatat e Kombeve të Bashkume edhe pse nuk kanë qenë shumë, shumë konstruktive në atë kohë në raport me shqiptarët. Por, sidoqoftë ka pasë një lloj depërtimi të të huajve në Kosovë edhe interesim të shtum të mediave ndërkomhtarë në Kosovë.

Prej vitit ‘90, ‘91 e tutje ka pasë gazetarë që rregullisht e kanë përcjellë situatën në Kosovë. Për shembull, ka qenë kryeredaktore tash osht’ e lajmeve, e Radios publike zvicerrave në Bern osht’ Irene Meyer. Prej vitit ‘91 e derisa ka përfundu lufta, ajo ka pasë tonë kohën vizita të rregullta edhe bile e pat bo një seri me mu si personi që kom qenë, si serial gati ka qenë. Domethënë, ajo sa herë që ka ardhë e

⁷ *Shuttle diplomacy* është veprim i një pale jashtë për të shërbyer si ndërmjetës midis drejtuesve në një mosmarrëveshje, pa kontakte të drejtpërdrejta nga drejtori-te-drejtori.

ka bo një intervistë me mu edhe publiku i saj në Zvicërr e ka ditë saktësisht çka po ndodhë në Kosovë, tu i marr parasysh ato rrëfimet e mia që kanë qenë personale. Por përmes personale, ti faktikisht e ki transmetu se ki qenë, për shembull në atë kohë më burrin dy vetë me fakulltet, pa punë, me katër fmi edhe krejt sfidat e rritjes tyne, qysh fmitë tonë s'kanë pasë qasje në shkollë, qysh ka qenë segregacioni që ka ndodhë, e krejt.

Domethënë, ka pasë secili prej menyrës së vet e ka prezantu njëfarë realiteti jashtë edhe interesi u shtu edhe atëherë veç u patën bo në njëfarë mënyre edhe kontaktet mes organizatave të grave, organizata që u themelun në Kosovë si për shembull "Organizata për Mbrojtjen e Grave dhe Fmive", ka qenë Sevdije Ahmeti, Vjosa Dobruna, motrat Qiriazhi, ka qenë Igo Rugova, se tash edhe gjyna me hi n'gjyna me tjerët që harroj m'i përmend (buzëqesh). Por, ka qenë për shembull Edita Tahiri me Edi Shukrinë prej LDK-së. Ka pasë shumë gra në këto struktura, të cilat faktikisht veç fillun me depërtu jashtë, apo fillun njerëzit prej jashtë me i njoft. Edhe atëherë veç u vetëdijësua se si duhet me e ngrit vetëdijen, jo veç vendore por edhe ndërkombëtare. Nuk ish mo qëllimi i protestave veç vetëdijësimi i qytetarëve apo protesta kundër Serbisë, por ka qenë ma shumë sensibilizimi i opinionit ndërkombëtar për situatën në Kosovë.

Tani qato kanë ndodh, domethënë gratë kanë qenë gjithmonë të konsiderume si... domethënë një protestë e grave është konsideru shumë ma e parrezikshme për gratë që marrin pjesë, në krahasim me një protestë ku marrin pjesë burrat. Për shkak që gratë jonë pa gjithmonë si ma paqësore, ma t'pa rrezikshme, që nuk marrin armë me veti (buzëqesh), që nuk shkaktojnë trazira. Kështu që, qajo ka qenë domethënë. Protesta e parë ka qenë me letra, e dyta ka qenë me bukë për nanat edhe fëmijët e Drenicës. Ajo protesta me bukë ka qenë në kohën kur faktikisht Drenica ka qenë totalisht e izolime prej pjesës tjetër të Kosovës, edhe brenga jonë kryesore ktu që ishim, domethënë njerëz në Prishtinë ishte si t'i qasen, domethënë sa munden m'u furnizu me ushqim? Si mujn me ardhë gratë që kanë terminin e lindjes, për shembull me ardhë me lindë jashtë Drenicës? Se aty s'kish kurrëfarë shërbimi shëndetësor, çka bojnë njerëzit që janë në dializë? Edhe na krejt këto gjana i kemi diskutu shumë gjatë me organizata ndërkombëtare, mes vete për me mujt me bo njëfarë sensibilizimi ma të madh për me u organizu kjo protesta me bukë edhe jemi nisë për drejtim të Drenicës.

Aurela Kadriu: A mendojshnit që keni me mbri në Drenicë?

Florina Duli: Kur jemi nisë kemi mendu që kemi me mbri edhe pse deri sa u bonëm grupi, e deri sa u mbledhëm ka qenë shumë e lodhshme, se jemi mbledhë atë ditë ku ka qenë përpara që i thojshin "Stacioni i trenit", afër zyrës amerikane jemi nisë në drejtim të Fushë Kosovës edhe normalisht që s'na kanë lonë me shku.

Aurela Kadriu: Çka ndodhi mandej?

Florina Duli: E di që na kanë ndal bash tash ku osht', nëse më kujtohet mirë tash ku osht' Deloitte, ku osht' Ambasada Britaneze në Fushë Kosovë, atëherë s'ka qenë autostradë, ka qenë vetëm rrugë magjistrale. Na kanë dalë policia edhe faktikisht në marrëveshje me udhëheqsinë u dashtë, kemi vendosë që duhet me u kthy se nuk e vlente barra qiranë, se nuk ish punë që ti rezistojsh edhe

mujshë me i rezistu deri në Drenicë. Ajo hecja nuk ish thjeshtë qëllimi përnime për me i çu bukët, domethënë efekti që e kish medial për ndërkombëtar ma shumë, kështu që aty jemi kthy (buzëqesh). Nuk më kujtohet shumë ajo pjesa a kanë përdorë gaz lotësjiellës apo jo, se e kom shumë të mjegullt atë... {merr gotën dhe pin ujë}.

Aurela Kadriu: Ku i morret bukët?

Florina Duli: Secili i ka... unë për veti e kom ble edhe mendoj që secili i ka... ka pasë edhe kanë shpërnda furrat kanë pru bukë, por ka pasë edhe shumë të tillë që e kanë ble kur janë nisë prej shpie, meqenëse e kemi ditë që kemi me... nuk mundeni me marrë me mend nivelin e solidaritetit që ka qenë në atë kohë, osht' i pa përshkrushëm. Atëherë as nuk e ke mendu atë pjesën materiale të angazhimit në asnjë moment, gjithëmonë ka pasë. Tash kur e mendojmë për iniciativa mendojmë ku do t'i marrim paret për një baner, për një ashtu, për një kështu. Atëherë ka qenë shumë, shumë spontane edhe pjesa ma e vogël e brengës ka qenë ajo ku kemi m'i marrë mjetet për me organizu diçka, se krejt kanë ardhë, ka pasë shumë, shumë solidaritet mes njerëzve, por edhe investim vetanëk të njerëzve në çkado.

Aurela Kadriu: E protestat tjera? Më duket shumë interesant se secila e ka pasë një simbolikë, pse i keni mendu kështu secilën me njëfarë simbolikë të veçantë?

Florina Duli: Po qajo ka qenë sensibilizimi i opinionit ndërkombëtar. Tani ka pasë shumë protesta të cilat e kanë pasë thjeshtë simbolikën, domethënë kanë qenë veprimi që u dashtë edhe revolta që u dashtë me shpreh njerëzit, u dashtë me gjetë njëfarë mënyre njerëzit me nxerrë jashtë gjithë atë revolt që u ndërto me vite të tana. Për shembull, po më duket që ka qenë viti '91 kur ka pasë protesta andej ka pjesa e... jonë bartë prej pjesës së Medresesë në pjesën ka Kodra e Trimave edhe në atë kohë patën vra, u patën vra dikun 21 vetë. Në atë kohë e di që unë s'kom mujt me dalë, se e kom pasë njënen vajzë tepër të vogël, e vogël ka qenë bebe edhe pse zakonisht i kom lanë e kom dalë, por atë ditë s'më la nana se e shikojshim prej kodrës çka osht' t'u ndodhë, ish thjeshtë luftë. Kanë përdorë plumba që kanë qenë që shpërthejshin, plumbat e gomës por edhe plumba që kanë eksplodu në trup edhe një djalë...

Motra jeme ma e vogël se unë e pat pa një djal që fatkeqsisht, domethënë nuk kish dhonë shpirt por e kish komplet trunin jashtë në tokë. Domethënë, pjesën e trunit, kafkën e shpërthyme {lëviz duart rreth kokës} dhe truni që po pulsonte në trotuar. Dhe ajo ka qenë e traumatizime për një kohë shumë të gjatë. Masandej, edhe na mas asaj kemi dalë krejt qytetarët në mënyrë shumë spontane me ndez qirinj në qendër të Prishtinës edhe ka qenë komplet ajo çka tash osht' sheshi "Nënë Terezë", komplet kjo rruga prej Qeverisë deri te, prej "Nanës Terezë" deri te "Zahir Pajaziti", komplet ka qenë e mbulume me qirinj prej qytetarëve. Ka qenë thjeshtë, ndonjëherë s'ka pasë ndonjë qëllim tepër të madh, por thjeshtë me nxerrë atë revoltën prej vetes edhe me u shpreh dikund, se ndryshe ke eksplodu prej mllefit, prej padrejtësive që veç jonë shtresu nonstop.

Aurela Kadriu: E qysh osht' bo mobilizimi, thirrja e grave në '98-tën?

Florina Duli: Ka pasë, u bo shumë... meqenëse media s'kemi pasë na edhe teknologjia informative s'ka qenë e zhvillime, na s'kemi ditë as me përdorë internetin edhe pse ka ekzistuar qysh atëherë komunikimi me e-mail, por ktu s'kanë pasë shumë qasje njerëzitet. Por osht' bo gojë më gojë, osht' bo organizatat domethënë osht' përcjell *word of mouth* [Eng. fjala e gojës] që thojnë shumë shpejt. Por ka pasë, për shembull organizimet që kanë qenë në Kosovë atëherë, ma lehtë ki ardhë deri te informata atëherë se tash. Për shembull, e ki pasë "Nanën Terezë" me ndoshta dyzetë mijë vullnetarë, domethënë secila lagje e Kosovës e ka pasë përfaqësuesin e vet.

E ke pasë të njëjtën me Këshillin e të Drejtave të Njeriut, çdo lagje e ka pasë përfaqësuesin në Këshill, se ka qenë dega, ka qenë nëndega se atëherë bojshim hajgare me këto punë se thojshim, jo pipi. Faktikisht ka qenë organizim i mrekullueshëm se kemi mujt me shpërnda fjalë, ke mujt me mbledhë informata, por edhe me shpërnda informata në të njëjtën kohë në mënyrë shumë efektive. Tani ka qenë edhe LDK-ja gjithashtu ka qenë, LDK-ja në atë kohë s'ka qenë parti politike, ka qenë lëvizje qytetare, organizimi ka qenë fenomenal i shtrim. Secila lagje e Kosovës ka qenë e mbulime në njëfarë mënyre.

Aurela Kadriu: Ku keni qenë luftës?

Florina Duli: Në luftë unë kom qenë në Prishtinë deri me 19 shkurt '99. Por, unë e kom lindë fëmijun e fundit me tetë shkurt '99, kështu që prandaj kom qenë edhe në pushim të lindjes në atë kohë edhe me 19 shkurt na kanë rrethu shpinë tri vetura autobllinda para shpisë tonë. Nuk e dishim a jonë apostafat për neve apo kanë ardhë për dikond tjetër, apo veç ishin stacionu aty edhe pse ajo ka qenë një lagje shumë e zakonshme. Kështu që, nuk ka qenë e zakonshme me u parku autobllindat aty. Edhe kur kanë ardhë, domethënë ka ora gjashtë në mëngjes, i ka vrejtë ma s'pari nana ime që po rrinte me mu për shkak që kisha lind bebe edhe me më ndihmu pak (buzëqesh). Edhe ajo e ka pa në gjashtë në mëngjes që jonë aty, por ka mendu që janë forcat e OSBE-së, se atëherë ka qenë misioni verifikues i OSBE-së, *Kosovo Verification Mission* [Shprehet në gjuhë angleze] edhe ata kanë pasë autobllinda, por i kanë pasë me ngjyrë portokalli, jo të gjelbërta si ushtria serbe. Edhe më tregoi mu, tha, "Janë disa autobllinda, por po më duket se jonë të OSBE-së". Unë s'e kom marrë shumë seriozisht.

Në ora pesë masdite një herë erdh vllau, pastaj motra, se krejt kemi qenë në një lagje kemi jetu, prej punës edhe ata po tregojnë që të nesërmen e kanë ndërmend me u evaku organizatat humanitare me të cilat kanë punu. Edhe po më thojnë, "Ti si po don me ja bo?" Por, ku kanë ardhë me më pyt mu, se nuk dojshin me shku pa mu e kanë pa që... se na s'kemi dalë me shiku se dhomën e ditës s'e kemi pasë me dritare nga rruga. Edhe ata po thojnë, "Çka jonë këto autobllinda para derës tonde? Kur dulem na me hy në shpi, ata dulen me na pa". Atëherë e kuptova që faktikisht prej orës gjashtë në mëngjes janë aty. Ndoshta kanë qenë edhe ma përpara por s'i kemi pa. Edhe pritëm na që po shkojnë, prit, prit u bo ora dy e natës nuk shkun (buzëqesh). Edhe pastaj, unë e kom pasë një ofertë prej një amerikanit, ai ka qenë ktu me mision me Mercy Corps International, me grunë e vet ka jetu në Kosovë, me ma nxerr mu djalin ilegalisht prej Kosovës, se ai e dinte që kena me qenë shënjestër.

Une s'e mora shumë seriozisht kur ma boni ofertën. Tha, "A po don ti m'i nxerrë fmitë? Unë po ta nxerri djalin". Se djali nuk kish kurrëfarë dokumenti, domethënë as çertifikatë të lindjes, se ka lind në "Nënë

Terezë”, në ambullantë të “Nanës Terezë”. Unë atëherë kom shku te nana edhe e kom thirrë atë amerikanin, thashë, “A vlen oferta jote me ma nxerr djalin ilegalisht prej Kosovës?” Tha “Po”. Kështu që, atë ditë kemi ikë na, faktikisht të nesërmen kemi ikë. Njëherë i kom çu fmitë në Maqedoni, tani ja kom dhonë djalin këtij amerikanit Terry Ohis Elius e ka pasë emrin.

Aurela Kadriu: Qysh dole prej shpisë?

Florina Duli: Ka qenë shumë interesant se unë niherë kur shkum, në dy të natës jemi shku te nana t’u mendu që katër shpija ma andej po jemi shumë ma të sigurtë, se ku ishim këtu (buzëqesh). Por, dulëm me dy grupe, meqenëse unë isha unë isha vet e shtata, se gjashtë fmi i kom, pesë vajza edhe një djal edhe motra. Në të vërtetë, një grup të fëmijëve ma mori vllau, njëherë shkoi ai edhe e mori vajzën e vogël tri vjeçe që ishte në atë kohë.

[Video-intervista ndërpritet. Pjesa në vijim është vazhdimësi e pjesës paraprake.]

Domethënë, vllau e murr gjysën e familjes me i çu deri te nana që me mujt une me motrën me shku ma vonë, me pa ata ni herë terrenin. Edhe kur niset ai rrugës e përcjellë njona prej autoblivdave gati deri në shpi. Ai ndalet te një dyqan, edhe pse ka qenë dy pas mesnate e kemi pasë një dyqan të lagjes që ka ndejt si roje ma shumë, ka ndejt hapun për me mujt me vëzhgu situatën edhe kinse po e blen një buk për me i tregu atij që jonë t’u na ndjekë e që jonë aty autoblivda. Dalin ata serbtë prej autoblivdës krejt me maska, me armë të gjata të veshun krejt zi edhe ja u drejtojnë tytat fëmijëve në makinë. Në makinë kanë qenë fëmitë e vllaut edhe vajza jeme tre vjeçare edhe ata trishtohen, normalisht që trishtohen krejt. Edhe vajza jem si mbrrin te shpija e nanës më thirrë mu në telefon edhe t’u bërtit e tu qajt, është kështu edhe pak dramatike (qesh), por edhe ish traumatizu keq. Edhe m’ka thirrë e më thonte, “Mos u nis nana se kanë me të vra ty edhe beben”. Por na s’kishim zgjidhje tjetër, kështu që u nisëm edhe na.

Edhe neve na përcollën njejt deri te nana. Aty e kthyn autoblivden edhe e panë mirë ku jemi t’u hy, por tash mo ish vonë, na s’kishim çka me bo, vendosëm me ndejt aty bashkë të gjithë. Domethënë, familja e vllaut, motra, unë me familjen tem krejt. Edhe e thirra unë këtë amerikanin që m’kish ofru, Terrin edhe i thashë, “Terry, a vlen oferta jote?” Se e pash që me të vertetë shënjestër edhe nëse nuk e largoj djalin ilegalisht mujnë me psu krejt familja. Edhe ai tha, “S’ka problem, oferta vlen”. Edhe pse ish dy pas mesnate nuk i pengoj aspak që e thirra në telefon, se ish situatë shumë e jashtëzakonshme. Edhe tha, “Po unë po shkoj me organizatën time, me kolegët po shkoj në Maqedoni edhe kthehem me ta marr djalin. Ti në ndërkohë rahatoji vajzat, domethënë çoji vajzat”. Kështu që, na e lamë që ata me ardhë me marrë djalin ka ora njëmbëdhjetë.

Na jemi çu në gjashtë në mëngjes, në të vërtetë s’kemi flejt hiç edhe kemi shku në Maqedoni deri në kufi. Motra asnjëherë s’kish drejtu veturën kështu në rrugë të gjatë, përveç nëpër qytet, por s’kish çka me bo, zori. Shkum deri në kufi. Unë e kalova në kambë kufinin, i hypa vajzat në autobus, ju lash edhe pak lekë, adresën e tezës që jeton në Shkup që me marrë taksin me shku te ajo me na prit deri sa të kthehemi na. Por, në kthim e sipër mu më dalin të dy kufitarë edhe kufitarin që rrin te dalja edhe të hyrja për Kosovë edhe thanë, “Pse po kthehesh ti? Na të pam që dole me fmi”. S’kish lëvizje aspak gati

në kufi atë kohë, kështu që secili binte në sy. Edhe unë i thashë që kom m'u kthy në punë, se nuk disha çka me ju thonë, që kom mendu me kalu prapë me djalin.

Kështu që, ata e fillun me më thonë që nëse kthehesh ti s'ki mi pa asnjëherë fmitë, a e din çka o tu ndodhë në Kosovë, ktu ka me rrjedhë gjaku si lumë, është lufta. Drejtë me të thonë, qëllimi i tyne nuk ishte i keq, por i ka ardhë keq që dikush p'i len fëmijët jashtë e s'pe shfrytëzon rastin mos m'u kthy. Unë aty e kuptova që faktikisht e kisha humbë shancin me kalu ma atë kufi me djalin, se ata ndrrimet i punojshin prej orës shtatë në mëngjes deri në shtatë në mbramje, na u duhke patjetër gjatë ditës me kalu kufinin. Kështu që, aty automatikisht mora vendimin që unë mos me shku me djalin me një veturë.

Kështu që, u kthym në Prishtinë edhe vllau ja kthyn vajzat se ju kish skadu paraporta. Domethënë, vllau u detyru m'u kthy bashkë me vajzat në Prishtinë. Edhe unë qaty për qaty e bonëm planin që thashë, "Okej, unë po t'i marr vajzat, po t'i kaloj ka Presheva e ka kufini këndeje ka Gjilani e ti..." Vendosa që me ja dhonë djalin Terryt edhe Nelly, grusë së vet me na kalu ka Maqedonia. Ata e kanë mshef në makinë djalin edhe faktikisht fati i tij që kish fillu me qajt bash në kufi kur kanë qenë. Por, ata [kufitarët] pritojshin përpara me dalë, te pjesa maqedone ka fillu me qajt por Terry tregoi që, "Unë dola me pasaporta jashtë, se ata pritojshin me dalë prej kabinave m'i kontrollu pasaportat". Kështu që, tha s'e kanë ndëgju.

Unë në atë kohë i kom kalu vajzat e vllaut ka kufini tjetër me fotografitë e fmive të mi. Pra, çka ka qenë atë ditë interesant ka qenë që na gjatë kthimit, unë edhe motra Rrezja, ata të kufinit na lutën me marrë nje gru, një serbe me kthy deri në Viti. Thanë, "Ka ardh e varfër" edhe në krejt atë situatë që na ikshim prej serbëve, po na japin. Ajo ish e veshun me të zeza edhe me lonë deri te kthesa për Viti edhe neve na erdh keq e murrem. Ajo tani na tregoi rrëfimin e vet, që i kish vdek vajza, që dhandri i rrite fmitë e ajo kish shku në Maqedoni m'i marrë do tesha prej do kusherive për m'i vesh fmitë që s'kishin buk me hangër. Edhe neve qaq na erdh keq, saqë vendosëm dyjat me ja lonë ka njëqind marka m'duket në atë kohë si ndihmë asaj grusë. (buzëqesh)

Tani t'u ardhë në shpi i thojsha motrës, "Paramendo, na prej atyne po ikim e po i ndihmojmë materialisht një pjestare", por ajo domethënë prapë ish gjithmonë individuale edhe ajo politika e madhe nuk kanë lidhje me njona-tjetrën, por ka qenë ditë e fshtirë. Ne jemi, krejt ky evakuim ka fillu në ora gjashtë në mëngjes, ka përfundu dikun ka ora dhjetë e gjys e natës jena bo krejt bashk në Shkup, krejt familja. Për me vazhdu tani me metë në Tetovë nja katër muj. (buzëqesh)

Aurela Kadriu: Çfarë keni bo tani sa keni nejt andej si refugjatë?

Florina Duli: Po unë për vete isha në pushim të lindjes edhe kom mendu që tash jom në shpi, por çka nënkuptonte pushimi i lindjes kur punon për një organizatë që ka funksionu në Kosovë edhe tash jemi refugjatë në Maqedoni? Edhe në atë kohë një kolege e jemja britaneze që sapo kish fillu me punu në Save the Children ku unë punojsha më thirri më tha, "Të lutem hajde puno se unë s'po di me u gjindë vet", se unë kom qenë gati si ndihmues i mirë.

Aurela Kadriu: Pas bombardimeve a?

Florina Duli: Jo, para bombardimeve, menjëherë domethënë para bombardimeve hala kishin fillu njerëzit m'u mbledhë edhe më thirrri ajo mu. Kështu që, unë u dashtë me dalë edhe me fillu. Domethënë, në fillim e vëzhgojshim kufinin, nuk e kishim të qartë as çka jemi t'u bo se ish situatë e padefinime mirë.

Aurela Kadriu: Ju u kthyt në Kosovë para bombardimeve?

Florina Duli: Jo, me punu në Maqedoni me Save the Children që ishin evaku, se krejt organizatat u evakun me 20 shkurt [1999], një muj para bombardimeve. Për shkak që 20 shkurti ka qenë data kur është dashtë m'u nënshkru Marrëveshja e Rambujes. Po ta kish nënshkru pala kosovare, bombardimet ishin dashtë me fillu ma herët shumë, por shtyrja e nënshkrimit e ka shty edhe datën e bombardimeve. Por, unë, domethënë kom fillu para bombardimeve me punu.

Më kujtohet që në fillim shkojshim si pula pa kry se s'dishim çka me bo. Tani kur fillun me ardhë trenat mo ish veç e qartë çka duhet me bo. Në fillim i thirrshim njerëzit me ju tregu, se i mbledhshim përvojat e njerëzve që e kalojshin kufinin, se si kanë ardhë, ku ka punkte, çka u dashtë me bo, si i kanë ikë situatës. Edhe faktikisht e bonëm njëfarë *mapping* [Eng. hartëzim], krejt vullnetarisht ne individë të ndryshëm që ishim aty. Edhe thjeshtë e dishim sakt se nëse niset një familje ku kanë punkte, çka duhet me bo edhe e bonëm qat *mapping* edhe tani i thirrshim njerëzit të cilët mujshim me i mbrri, se edhe telefonat nuk punojshin. Edhe ju tregojshim që nëse nisen, duhen me marrë pare, ka pesë marka sa ma shumë që t'kanë tima që me ditë sakt ku punktet m'i evitu, qysh duhet me vepru edhe sa është e sigurtë për me kalu deri në Maqedoni.

Se me të vërtetë qëndrimi në Kosovë s'ka qenë shumë i arsyeshëm në atë kohë, se ka qenë shumë me rrezik të madh edhe qajo. Gjatë asaj kohe na shpinë i kemi pasë dhonë çelsat një familjes, faktikisht tani ka qenë nuk e di a osht' hala kryeredaktori i "Epokës të re", Muhamet Mavraj, ka qenë me Lëvizjen Studentore ai në atë kohë, e atij edhe familjes të vet ja patëm dhonë çelësin e shpisë, që ai ka ndejt në shpinë tonë deri ditën kur kanë ikë me veturën tonë. Ja pata tregu unë ku e kemi veturën që me marrë edhe me ikë në Maqedoni edhe ata, qeshtu (qesh).

Aurela Kadriu: Kur u kthyt në Kosovë, çka ju tregun për shpinë ma s'pari?

Florina Duli: Unë u nisa me Save the Children, jom nis me 13 qershor, domethënë me 12 ishte, erdh KFOR-i, ka qenë dita e parë që erdh KFOR-i mas marrëveshjes të Kumanovës, e me 13 qershor vendosëm me Save the Children me ardhë me kushtet për fillimin e punës. Kur u nisëm për, domethënë kur u nisëm ne veç kisha ndëgju që me 11 qershor është djegë shpia edhe mu m'ka ardhë një fqinje me më tregu në Shkup. Na u nisshim për Tetovë se shumë kolegë punojshin në Tetovë edhe u mbledhshim u kthejshim gjithë me një furgon. Edhe motra në të vërtetë ish nisë me shku te një pritje ku ish Madeleine Albright, me USAID punonte ajo. Po vjen një kolege më tha, "Mos u nis për Tetovë", tha, "të lutem pritëm pak". "Okej", thashë me siguri i ka ndodh asaj diçka, se asaj i ndodhën shumë tragjedi edhe shumë prita me ndro shumë të madhe çka ka mujt me i ndodhë ma tepër se qaq.

Kur erdh ajo tha, ish zbeh krejt. Unë thashë, “Tregom, çka t’ka ndodhë?” Tha, “Jo mu, ty”. Kur më ka thonë ty, veç e kom paramendu që m’ka ra naj fmi prej terasës të banesës në Tetovë që e kishim në kat të katërt. Kur ka thonë, “T’u ka djegë shpia”. M’u ka dukë që ma ka dhonë lajmin ma të bukur në botë. Thojsha, veç të sigurtë jë jemi, se punë e madhe shpia. Edhe nuk e morra kështu me shumë, shumë lehtë e pranova lajmin. M’ra tani në kry, se ish problem kur i ki gjashtë fmi e s’ki ku me u kthy në shpi. Kështu që, na kemi qenë ndër t’parët që ikëm, por tani kemi qenë gati të fundit që u kthym krejt familja.

Unë u ktheva me 13 qershor edhe mbeta ktu me punë. Vendosëm me hap zyrën, fillum me implementu programin, njerëzit kishin nevojë e vazhdum projektin e bashkimit familjar. Na në Maqedoni. faktikisht ka qenë edhe në njëfarë mënyre dizajn i jemi ai program. Nëpër kampe ju çojshim telefona mobil që na i fali “British Telekomi” njerëzve, për me pyt ku i kanë pjestarët e familjes edhe ka qenë një program tepër i suksesshëm. Gati krejt u gjetën shumë shpejt njerëzit mes vete. Na i pritshim në radhë njerëzit, folshin një minut, kur kishin lajme të qkia i jepshim ma shumë kohë me folë. Shumë e fshtirë ka qenë si punë, se njerëzit, ata vullnetarët që punojshin me telefona ndëgjoishin gjithçka edhe vijshin të dërmum emocionalisht.

Por atë program e vazhdum edhe në Prishtinë te tash Qendra e Rinisë i vendosëm zyrat me KFOR-in bashkë, ku i vendosëm telefona satelitor për njerëz me marrë vesh për pjesën e familjes që nuk e dijnë. Kish shumë të zhdukun edhe mbeta unë në Prishtinë, domethënë me punu. Familja mbet në Tetovë edhe kanë mbetë atje. Deri me 15 korrik kemi qenë të ndamë se s’kishin ku m’u kthy. Dikur vendosën me shku te shpija që ka qenë e kunatit tem. Aty ndejtën një kohë, derisa i bonëm zgjidhje, por ka qenë shumë e fshtirë, shumë e fshtirë, se ti domethënë papritmas je i pa shpi me gjithë atë familje të madhe (buzëqesh). Oferta kishim plot me shku te njerëz, por kërkujt nuk i shkohet me gjashtë fëmijë të vegjël. Domethënë, ma e madhja ish 16 vjeç, por ish edhe një bebe.

Kështu që, vendosëm mos me pranu asnjë ofertë, por me ndejt në Tetovë deri sa ta bojmë një zgjidhje të përkohshme. Tani e blejtëm, vendosëm me ble një shpi me borxh tepër të madh prej një serbit afër shpisë ku e kemi pasë edhe kështu. Na bonën oferta edhe disa familje serbe me ja u rujt shpiat që u tutshin që po ja djegin edhe thojshin, “Rrini pa pare, veç runani shpinë”. Por, mu s’mu duke shumë e drejtë une me ja u rujt shpinë dikujt që ka festu kur ma kanë djegë temen (buzëqesh) edhe nuk isha emocionalisht e gatshme me ndejt dikun që nuk e di a ka me qenë e jemja, a s’ka me qenë e jemja. Dojsha me bo zgjidhje ma afatgjate, kështu që blejtëm shpi. Një shpi bajagi kështu e rrënume e s’ka qenë në gjendje shumë të mirë, por bonëm zgjidhje, kryesorja kulm kishim (buzëqesh).

Aurela Kadriu: Qysh ka vazhdu mandej jeta juj mbas krejt ktyne?

Florina Duli: Mas ksaj unë vazhdova me punu me Save the Children një kohë, nja gjashtë muj mas lufte edhe në atë kohë e bonën një gazetar gjerman boni një storje për shpinë tonë. Na kemi pasë shumë libra edhe kur u djegë shpia jonë ajo vajza jonë e vogla që i kish tri vjeç nuk dinte me thonë, “Na e kanë djeg shpinë”, por thojke “Na e kanë vra shpinë”.